



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 17.10.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

Mbi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin 2005 të Konventës për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar, aderuar me ligjin nr.8850/2001, dhe Protokollin 2005 të Protokollit për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse në shelfin kontinental, aderuar me ligjin nr. 8850/2001”.

Drejtuar: Seancës Plenare

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjen e datës 16.10.2018 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin 2005 të Konventës për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar, aderuar me ligjin nr.8850/2001, dhe Protokollin 2005 të Protokollit për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse në shelfin kontinental, aderuar me ligjin nr. 8850/2001”.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator deputeti Vullnet Sinaj .

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORË TË MARRËVESHJES:

Qëllimi i këtyre dy protokolleve, është amendimi i dy akteve të vitit 2001 dhe aderimi i Republikës së Shqipërisë në këto protokolle të konventave është pjesë e angazhimeve të ndërmarra nga vendi ynë si anëtar i OKB-së dhe kryhet në kuadër të përmbushjes së prioritetëve të qeverisë shqiptare në luftën kundër krimit në tërësi, goditjes së trafikimit, akteve terroriste, të cilat synojnë të realizohen në rrugë detare.

Protokollet e konventave janë iniciuar në kuadër të legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me mbarëvajtjen e paqes dhe të sigurisë së lundrimit ndërkombëtar, duke promovuar siguri, marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare.

Aderimi në këto organizma synon të forcojë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), për të rritur efikasitetin në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, në aspektin e sigurisë detare, duke bashkëvepruar me organet kompetente.

Përparësitë që priten nga aderimi i Republikës së Shqipërisë në protokolle lidhen me fushën e goditjes së krimit, akteve terroriste, sigurisë publike në rrugë detare, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit. Palët do të ndërmarrin masa të përbashkëta kundër akteve të kundërligjshme detare, duke bërë të mundur goditjen e tyre, me qëllim ruajtjen e sigurisë detare.

Republika e Shqipërisë, nëpërmjet aderimit në këto protokolle, bën të mundur realizimin e një hapi përpara drejt konsolidimit të kuadrit ligjor detar.

- **Protokolli i vitit 2005 i Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Lundrimit Detar.**

Neni 1, i Protokollit përcakton kuptimin e Konventës dhe institucionet ndërkombëtare përgjegjëse, për zbatimin e tij.

Neni 2, i Protokollit ndryshon nenin 1, të Konventës dhe përkufizon termat, për qëllim të zbatimit të saj.

Neni 3, i Protokollit, është shtuar si neni 2bis i Konventës dhe plotëson fushën e saj të zbatimit, duke përcaktuar çështjet dhe fushat ku kjo Konventë nuk gjen zbatim.

Neni 4, i Protokollit ndryshon nenin 3, të Konventës, paragrafin 1, germën “f”, të paragrafit 1, heq paragrafin germën “g”, të parag. 1 dhe zëvendëson përmbajtjen e paragrafit 2, ku përcaktohet se:

“2. Çdo person kryen gjithashtu një vepër penale, nëse ai person kërcënon, me ose pa kusht, siç parashikohet në të drejtën kombëtare, me synim detyrimin e një personi fizik ose juridik për të kryer ose mos kryer ndonjë veprim, për të kryer ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në paragrafët 1 (b), (c) dhe (e), nëse ky kërcënim mund të rrezikojë lundrimin e sigurt të anijes në fjalë.”

Pikat 5, 6 dhe 7, të nenit 4, të Protokollit, zgjerojnë fushën e zbatimit të Konventës, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar shkeljet që përbëjnë vepër penale në zbatim të kësaj Konvente dhe rastet apo veprimet që nuk përbëjnë vepër penale, por që rregullohen në legjislacionin përkatës ndërkombëtar.

Neni 5, i Protokollit ndryshon nenin 5, të Konventës dhe përcakton detyrimin për Palët që, në përputhje me parimet e brendshme ligjore, të marrin masat e nevojshme për të mundësuar përgjegjësinë penale, civile dhe administrative të personave juridikë.

Neni 6, i Protokollit, reflekton ndryshimin e bërë në nenin 5, të Konventës, duke parashikuar detyrimin e Palëve për të marrë masat e nevojshme për të vendosur juridiksionin mbi veprat penale, sidomos në rastet kur nuk ekstradohet shkelësi i dyshuar.

Në nenin 7, të Protokollit është përcaktuar lista e akteve ndërkombëtare si shtojcë e Konventës, të cilat lidhen me zbatimin e saj nga Palët.

Neni 8, i Protokollit ndryshon paragrafin 1, të nenit 8, të Konventës dhe shton nenin 8bis, të Konventës, ku përcaktohen modalitetet dhe rregullat procedurale të bashkëpunimit të Shteteve Palë të Konventës me njëra-tjetrën dhe me Organizatën Ndërkombëtare Detare.

Neni 9, i Protokollit, ndryshon paragrafin 2, të nenit 10, të Konventës, ku parashikohet garantimi i trajtimit të drejtë, të personit të paraburgosur.

Neni 10, i Protokollit ndryshon nenin 11, të Konventës, parashikon si vepra penale të ekstradueshme, veprat e parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quarter.

Neni 11, i Protokollit shton nenin 12bis të Konventës ku përcaktohen rregullat për transferimin e personit të paraburgosur në një shtet tjetër.

Neni 12, i Protokollit, ndryshon nenin 13, të Konventës, duke parashikuar shkëmbimin e informacionit mes Palëve dhe marrjen e masave praktike për të parandaluar përgatitjen për kryerjen e veprave penale në territorin e një shteti tjetër.

Nenet 13-16, të Protokollit, parashikojnë ndryshime teknike në Konventë, në reflektim të frymës së Protokollit.

Nenet 17-24, parashikojnë nënshkrimin, ratifikimin, hyrjen në fuqi, denoncimin, rishikimin, deklaratat, depozitarin dhe gjuhët e Protokollit.

- **Protokolli i vitit 2005 për Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental**

Neni 1, i Protokollit përcakton kuptimin e Protokollit që ndryshohet, të institucioneve ndërkombëtare përgjegjëse, për zbatimin e tij.

Neni 2, ndryshon paragrafin 1, të Nenit 1, të Protokollit duke parashikuar zbatimin e Konventës dhe të Protokollit të 1988, edhe në rastet kur vepra penale është kryer në bord ose ndaj platformave fikse në shelfin kontinental.

Neni 3, i Protokollit ndryshon nenin 2, të Protokollit të 1988.

Neni 4, i Protokollit, bën një shtesë në nenin 2, të Protokollit të 1988, duke parashikuar veprimet që përbëjnë vepër penale, kryesisht të lidhura me aktet terroriste dhe krime të tjera.

Neni 5, i Protokollit, zëvendëson disa paragrafë të nenit 3, të Protokollit të 1988, në lidhje me juridiksionin e shteteve Palë për veprat penale të parashikura në këtë Protokoll.

Neni 6, i Protokollit, parashikon leximin dhe interpretimin e këtij Protokollit dhe atij të v.1988, si një akt i vetëm.

Nenet 7-13, të Protokollit, parashikojnë Klauzolat përfundimtare, në lidhje me nënshkrimin, ratifikimin, hyrjen në fuqi, denoncimin, rishikimin, deklaratat, depozitarin dhe gjuhët e Protokollit.

2. PËRFUNDIME

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare duke vlerësuar rëndësinë e kësaj marrëveshje dhe përfitimeve që sjell në luftën kundër krimit në tërësi, goditjes së trafikimit, akteve terroriste, të cilat synojnë të realizohen në rrugë detare, me shumicën e anëtarëve miraton projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi si dhe shprehet dakord për kalimin e këtij projektligji në seancë plenare.

Relator

Kryetar

Vullnet SINAJ

Ermonela (Felaj) VALIKAJ